



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjilan
Gilan Belediyesi

Duke u bazuar në nenin 40.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, në nenin 38 paragrafi 1.4, nenin 46 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës së Gjilanit, 01.Nr.016-126211 të datës 06.11.2014, në nenin 11 të Rregullores për punën e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e mbajtur me 29.12.2016, miraton këtë:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË
GJILANIT PËR VITIN 2017

1. Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Gjilanit miraton Planin e punës të Kuvendit të Komunës së Gjilanit për vitin 2017
2. Plani i punës i Kuvendit të Komunës së Gjilanit për vitin 2017 është hartuar nga Grupi punues për hartimin e Planit vjetor të punës, i emëruar me vendim të KK-Gjilan në seancën e datës 29.11.2016, dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ndryshimet dhe plotësimet në Planin e punës të Kuvendit mund të bëhen edhe pas miratimit të tij, përderisa çështjet që janë në kompetencë të kryetarit të Komunës, do të shqyrtohen edhe pa qenë të përfshira në planin e punës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Kryesuesja e KK-Gjilan
5. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr. 016-126441
Gjilan, më 29.12.2016

Kryesuesja e Kuvendit,
Valentina Bunjaku-Rexhepi